Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/440
Datë: 21.07.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen IV e mbajtur me datë 19.07.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet dhe validohet** Institucioni Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale e Mjekësisë "KEKA MED" B.I, Rr. Sadik Rama, Nr.397 në Klinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2023 deri 31.08.2026, me kualifikimin e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 Asistent dentar, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar të kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me njëzetepesë-deri tridhjetë (25-30) kandidat në një klase/grup, dhe 1 klasë/grup brenda vitit.

   1.2 Teknik i farmacisë, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji Kualifikim Kombëtar I Kombinuar (D) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me njëzet e tetë (28) kandidat në një grup, dhe 1 klase/grup brenda vitit.

   1.3 Bashkëpunëtor profesional i infermierisë, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (D) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me njëzet e tetë (28) kandidat në një grup, dhe 2 klasa/grupe brenda vitit.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale e Mjekësisë "KEKA MED" B.I,, për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale e Mjeksisë "KEKA MED" B.I, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar KD së AKK